

Takimi i Trojkës së SEECP-së

Tiranë, 22 shkurt 2015

Në datën 22 shkurt 2015, në kuadër të Kryesisë Shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), u zhvillua në Tiranë, Takimi i Trojkës të SEECP-së me pjesëmarrjen e Shqipërisë, Rumanisë dhe Bullgarisë si dhe përfaqësues të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal(RCC).

Kryesia shqiptare e SEECP-së, pasi evidentoi faktin se formati i trojkës mbetet shumë i rëndësishëm për kryesinë tonë të SEECP-së, informoi bashkëbiseduesit për kujdesin që Kryesia shqiptare i kushton parimit të gjithë përfshirjes dhe pjesëmarrjes së të gjithë pjesëmarrësve të SEECP-së në aktivitetet e parashikuara. Kryesia shqiptare shpërndau dhe një draft-raport të aktiviteteve të



deri tanishme të kryesisë sonë sipas kërkesës së Kartës së SEECP-së duke marrë dhe vlerësimet me këtë rast, si dhe u diskutua për pjesëmarrjen në aktivitetet e deri tanishme dhe rëndësinë që kryesia shqiptare i kushton vazhdimësisë së aktiviteteve në kuadër të organizatës.

Kryesia Shqiptare e SEECP-së ka synuar të realizojë në praktikë drejtimin politik të RCC-së përmes koordinimit të aktiviteteve dhe krijimit të sinergjive me Sekretariatit e RCC-së në Sarajevë. Në këtë kuadër, kryesia jone shprehu falënderimet për bashkëpunimin efektiv dhe u kërkua që ky nivel të vazhdoj edhe më tej në aktivitetet e ardhshme. U theksua që kryesia vazhdon të synojë përfshirjen sa më aktive të institucioneve të BE-së në aktivitetet e parashikuara.

Anëtarët e Trojkës, vlerësuan aktivitetet e deritanishme të kryesisë sonë dhe nënvizuan gatishmërinë për mbështetje si dhe përgëzuan iniciativën e Kryesisë për të miratuar Deklaratën Kundër Terrorizmit si një hap i cili kryhet për herë të parë në këtë format dhe dhanë mbështetjen e tyre për miratimin e saj. Bashkëbiseduesit vlerësuan koordinimin e aktiviteteve ndërmjet kryesisë sonë me RCC-në.